



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1893 /2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40 , 73, Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna neni 8, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 30, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit shpall:

K o n k u r s

Për anëtarë në Komitetet Konsultative të Komunës së Hanit të Elezit

- Komiteti për Arsim , Kulturë Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale pesë (5) anëtarë.
- Komiteti për Zhvillim Ekonomik , Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit pesë (5) anëtarë.
- Komiteti për Shërbime Publike dhe Emergjencë pesë (5) anëtarë.

Kriteret:

- Anëtarët e Komiteteve konsultative përbëhen nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët duhet të jenë njohës të fushave përkatëse .
- Përfaqësimi gjinor në Komitetet Konsultative duhet të jetë sipas legjislacionit në fuqi.
- Kandidatët për anëtar në Komitetet Konsultative duhet të jenë banor të Komunës së Hanit të Elezit.
- Përgatitja profesionale është përparësi.

Dokumentet e kërkuara: CV, Diploma, Certifikata e lindjes, Kopje e letërnjoftimit, Certifikata e vendbanimit.

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë do t'i nënshtrohen intervistimit.

Afati për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara është 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetë publike.

Dokumentet e pa kompletuara dhe ato që arrijnë pas kësaj date nuk do të shqyrtohen .

Mandati: Mandati i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është katër (4) vjeçar. Anëtarët e Komiteteve Konsultative nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme si anëtarë të atyre komiteteve.

Kompensimi: për punën e tyre në Komitetet Konsultative, anëtarët e këtyre komiteteve do të kompensohen në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme.

Kompetencat e Komiteteve Konsultative:

- Japin propozime për rregullore të ndryshme,
- Paraqesin propozime për hulumtime të ndryshme.
- Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, Komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushat përkatëse.
- Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
- Japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Hani i Elezit
Data: 06.03.2018

